




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

12 -10- 2023

Ref. 2310/889/BA/yf

Nr. 03/2023  
Dt: 11.10.2023

**Bordi për Ankesa (BA)**, i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Granit Mavriqi anëtarë, lidhur me Ankesën me numër Ref:2310/868/BA/yf të datës 06.10.2023 të parashtruesit “Armotion” Sh.P.K, të paraqitur ndaj Vendimit Ref:2310/840/KPM/j.m, të datës 03.10.2023 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datën 11.10.2023 mori këtë:

## V E N D I M

Bordi për Ankesa shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me Ankesën Ref.2310/868/BA/yf të datës 6 tetor 2023 të parashtruar nga Armotion kundër Vendimit Ref.2310/840/KPM/jm të datës 3 tetor 2023 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

## A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimit Ref.2310/840/KPM/jm të datës 3 tetor 2023, ka urdhëruar operatorët e shpërndarjes, që menjëherë t'i largojnë nga transmetimi kanalet ARENA SPORT, me qëllim të parandalimit të përmbytjeve programore të cilat cenojnë interesin nacional dhe sigurinë e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Kundër Vendimit të lartcekur në afatin e paraparë ligjor Armotion SH.P.K me datën 06.10.2023 ka parashtruar Ankesë pranë Bordit për Ankesa, me propozimin që të Anulojë Vendimin e Komisionit të Pavarur të Mediave të datës 03.10.2023, për shkak se i njëjti është nxjerrë në mënyrë jo të drejtë.

Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datë 11.10.2023 ka shqyrtuar dhe analizuar Ankesën, Vendimin Ref.2310/840/KPM/jm e datës 3 tetor 2023, dhe ka vendosur unanimisht si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi për Ankesa ka konstatuar se Vendimit Ref.2310/840/KPM/jm i datës 3 tetor 2023, është vendim me urdhër të karakterit të përgjithshëm dhe i njëjti prodhon efekt të gjithë operatorët shpërndarës në territorin e Republikës së Kosovës, i njëjti në dispozitiv të vendimit të KPM-së përcakton: Urdhërohen Operatorët e Shpërndarjes që menjëherë t'i largojnë nga transmetimi

kanalet ARENA SPORT, me qëllim të parandalimit të përmbajtjeve programore të cilat cenojnë interesin nacional dhe sigurinë e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Bordi për Ankesa, konstaton se Vendimi i atakuar me ankesë nga Artmotion Sh.P.K, është urdhër i karakterit të përgjithshëm dhe i njëjti prodhon efekt juridik të të gjithë operatorët e shpërndarjes, dhe bazuar në autorizimet ligjore të përcaktuara me nenin 36 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave përcakton:

*“2. Bordi për Ankesa shqyrton ankesat e palëve ndaj vendimeve të KPM-së që drejtpërdrejtë i nënshtrohen vendimit përsa i përket:*

*2.1. dhënies, refuzimit, mosripërtërirjes ose revokimit të lejes transmetuese;*

*2.2. vënies ose ndryshimit të kushteve të lejes së transmetimit, me përjashtim të kushteve që kanë të bëjnë me caktimin e frekuencave apo kritereve të tjera teknike;*

*2.3. shqiptimit të sanksioneve; dhe*

*2.4. çështjeve tjera të ngjashme që mbështeten në aktet nënligjore.”*

Bordi konstaton se bazuar në nenin e lartcekur të Ligjit të KPM-së, dhe marrë parasysh se vendimi i atakuar është urdhër i karakterit të përgjithshëm, nga ky fakt nuk ka kompetencë lëndore për trajtimin e ankesës Artmotion, dhe vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores BA-01/2023 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit në Gjykatën Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.



*Ylber Fetahaj*  
Ylber Fetahaj  
Kryetar i Bordit për Ankesa